



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 57/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në hapësira publike, trotuar, në seancën e panelit të mbajtur me 26.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 24.04.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, me datën 23.04.2012, në Rrugën “Dëshmorët e Kombit” dhe në Rrugën “Hamëz Jashari” në Ferizaj, ka shfrytëzuar hapësirat publik dhe trotuaret, duke i vendosur posterat e kandidatit të saj për kryetar të komunës së Ferizajt, si dhe duke e penguar kalimin e lirshëm të qytetarëve nëpër trotuar. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se nga ana e subjektit politik LDK është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregulla Zgjedhore 13/2009.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi, të kandidatit për kryetar komunës në Ferizaj nga radhët e subjektit politik të LDK.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, më datë 24.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.04.2012, në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) e LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) Nr. 11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar.

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit politik për ndonjë shkelje, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës shihet qart se posterat kandidatit për kryetarë komune të Ferizajt nga radhët e subjektit politik Adem Salihaj, janë të vendosura në rrugët publike për qarkullim të qytetarëve (trotuar), e që është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore prandaj më qëllimi të evitimit të shkeljes së lartë cekur dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 57/2012 më datën 26.04.2012

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**

